



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-15065/23 datë:19.06.2023



Npi – 01/255 datë: 27.06.2023

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 27.06.2023, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

IMBLEDHJES SË -VI- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 27.06.2023, (e martë) në ora 09.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Përparim Ramusa, z.Adem Ramadani, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Të gjithë Drejtorët, Zyrtari kryesor financiar, z.Bujar Ferati, Zyrtari për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore z.Reshat Gashi, Shefja e Kabinetit të Kryetarit znj.Anita Kurti, Asistente e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët e IT-së, Praktikantët, znj.Sadbere Halili dhe znj.Valmira Hoxha, nga RZSH-ë z.Muhamet Hoxha.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.05.2023,
2. Pyetje – përgjigje,
3. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026, (Pas diskutimit Publik)
4. **Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për verifikimin e ndarjes së Subvencioneve për OJQ-të (Pikë shtesë),**
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri,
6. Propozim-Vendim për plotësimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/32 për ndarjen nga 100€ për Nënat-Lehona për vitin 2023,
7. Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. numër P-03020-2 ZK-Shtime,
8. Propozim-Vendim për hapje të rrugës publike në Z.K – Karaqicë.

Kryesuesi, **z.Adnan Ademi**; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Rrahman Jakupi; Përshëndetje, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale propozoj një pikë shtesë "Propozim-Vendim për verifikimin e ndarjes së Subvencioneve për OJQ-të" te pika e 3 e rendit të ditës.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, në parim pajtoj me pikat e rendit të ditës, por lidhur me pikat 7 dhe 8 unë kamë kërkuar një dokument të Arkivës. Në Rekomandimin e drejtorisë është thënë në ligjin e vitit 2001. Nuk është sjellë rekomandimi për klasifikimin e tokës bujqësore.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E kemi një kërkesë nga klubi i Kik-Boksit dhe ajo kërkesë duhet me shku në DKRS-ë, e drejtoria me sjellë rekomandim për të gjitha kërkesat. Për OJQ-të ndarja e subvencioneve është një Komision që e ka kryer punën e tyre dhe ka mundësi që të ketë të pa kënaqur. Por ata kanë të drejtë ankese.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, nuk është ideja e PDK-së për me bë Komision mbi Komision por ne po kërkojmë me kanë një Komision për me vërtetu Komisionin se a ka punu në përputhje me Ligjin. E dimë për shumën e mjeteve.

z.Rrahman Jakupi; Veq po dojmë me verifiku a është bërë puna mirë nga Komisioni.

znj.Adelina Beqa; Përshëndetje, ti vet po diskuton, e tjerëve po u thua mos diskuto pa u miratuar rendi i ditës. Qite në votim e pastaj diskutojmë.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, pajtoj me rendin e ditës edhe me propozimin e Rrahmanit që të jetë Komisioni. Në këtë Komision kërkojë të përfshihet edhe një përfaqësues i opozitës LB.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, kemi një kërkesë nga klubi sportiv. Nuk po më duket gjest i mirë që në ndarjen e subvencioneve të hyjnë edhe Partitë Politike. Unë jam dakort që të rishikohen edhe një her vendimet për ndarjen e subvencioneve, por unë mendoj se fillimisht është më mirë me pas një raport nga Komisioni për ndarjen e subvencioneve.

z.Rrahman Jakupi; Nuk jamë duke bërë vlersim të vendimeve sepse ajo ka mbaruar. Ne po themi që Komisioni me qenë multipolitik i cili do të bën verifikimin e ndarjes së subvencioneve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për”, me 11 vota “Kundër” dhe me 0 votë “Abstenim”, nuk e miratoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit.**

*** Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për”, me 8 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim”, miratoi rendin e ditës me pikën shtesë “Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për verifikimin e ndarjes së Subvencioneve për OJQ-të, si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.05.2023,
2. Pyetje – përgjigje,
3. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026, (Pas diskutimit Publik)
4. Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për verifikimin e ndarjes së Subvencioneve për OJQ-të (Pikë shtesë),
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri,
6. Propozim-Vendim për plotësimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/32 për ndarjen nga 100€ për Nënata-Lehona për vitin 2023,
7. Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. numër P-03020-2 ZK-Shtime,
8. Propozim-Vendim për hapje të rrugës publike në Z.K – Karaqicë.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.05.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Ne si Komitet kemi bërë Rekomandim për me rritë stafin e Kuvendit. Ne po kërkojmë që me na ardhur procesverbalet me kohë, meqenëse ato po vonohen, ne po japim vërejtje që stafi të plotësohet dhe materiali me na ardhur me kohë. Nuk kam vërejtje për këtë procesverbal.

z.Rrahman Jakupi; Te faqja 3 e procesverbalit te diskutimi im është: “Vendimi për objektin e ngushëllimeve në fshatin Pjetërshticë a është konfirmuar nga MAPL-ja? E duhet të jetë si vijon: “Vendimi

për objektin e ngushëllimeve në fshatin Pjetërshiticë a është konfirmuar si i kundërligjshëm nga MAPL-ja” kështu duhet të jetë.

z.Adem Ramadani; Përsëritet, unë kam thënë se klubi sportiv Vjosa “Futsal” shpenzimet vjetore i kanë 85 mijë euro në vend të 35 mijë eurove se është e shkruar në procesverbal.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatohet Kourumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 31.05.2023.**

Pika 2

Pyetje – përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Pyetje për DSHP-në, kam një kërkesë për rrugën “Drita Mujota” ku nevojitet një pasqyrë e komunikacionit për rrugën që lidhet me rrugën e Jezercit kisha kërkuar që me u vendosë? Pyetje për Kryesuesin e Kuvendit, kur do të nisë formimi i këshillave të fshatrave?

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Përgjigje ne kemi kërkuar që zgjedhjet të bëhen në vjeshtë pas sezonës së pushimeve, sepse tash është koha e bashkatdhetarëve dhe nuk ka interesim të madh për këtë çështje, kjo është ideja.

znj.Adelina Beqaj; Pyetje për DPUKGJ-në, është bërë një kanalizim te rruga “Komandant Kumanova” që të qon për te shkolla e mesme kur do të rregullohet ajo pjesë? Pyetje për Kryesuesin e Kuvendit, drejtorat nuk janë prezent, kujt me ju drejtua?

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Përgjigje e keni mundësinë me i marrë përgjigjet me shkrim.

z.Përparim Ramusa; Nëse është fjala për punë në teren duhet të jetë Grejtalbi kompetent e jo të tjerët. Pyetje për DKA-në, tek subvencionet për ndarjen e bursave kërkojë që të shtyhet afati sepse më kanë shkruar studentët për shkak të provimeve? Pyetje për DSHP-në, por pa e përfshi drejtorin sepse drejtori nuk është prezent. Si është e mundur që 8 muaj nuk keni lidhë kontratë me “Pastërtinë”, ku i hidhni mbeturinat?

z.Adem Ramdani; Pyetje për DPUKGJ-në, pëlqimet mjedisore pse po vonohen? Pse nuk po e bëni një komision tjetër edhe për objektet e legalizimit? Pyetje për DPUKGJ-në, pse i keni ndryshuar kahjet e rrugëve te trekëndëshi? Pyetje për DPUKGJ-në, për trotuarin te rruga kryesore “Tahir Sinani” pllakat e bukura janë por janë të rrëshqitshme gjatë dimrit?

z.Muhamet Ademaj; Pyetje për DSHP-në, tek rruga “Kadri Ademaj” është prishë ndriçimi, kur do të rregullohet? Pyetje për DPUKGJ-në, kur do të nisë tenderi në rrugën “Skender Salihaj”? Pyetje për DSHMS-në, kur do të furnizohet me ujë QMF-ja në Petrovë?

z.Besnik Seferi; ; Pyetje për DPUKGJ-në, sa i përket një parku që është duke u bërë në Davidovc, a është planifikuar ndonjë zebër aty? Pyetje për DPUKGJ-në, a është planifikuar rregullimi i urës “Halil Hysenaj” sepse nuk është urë ajo? Pyetje për DSHP-në, a ka ndonjë informatë që është nga Komisioni i Aksionarëve sepse kanë marrë akuza unë personalisht?

z.Hamëz Tershani; Pyetje për DPUKGJ-në, te lagja “Ademaj” është ndërtuar një murë, a ka leje ai person sepse po pengohet qarkullimi?

znj.Besartë Musliu-Spahi; Pyetje për DPUKGJ-në, banorët janë të shqetësuar nga kompanitë që operojnë mbi Reçak me gurorë çka do të ndërmerrni? Pyetje për Kryetarin, çka po ndodhë me nxënësit në fshatin Zborc sepse ata ende nuk janë notuar?

z.Zejnie Veliu; Pyetje për DKRS-në, aktivitete për ditën e Çlirimit a keni paraparë ndonjë përkrahje për Ansamblin Dita? Pyetje për DSHP-në, a është paraparë vendosja e një pasqyre në ?

z.Albana Podvorica; Urime festa e Bajramit të gjithëve. Pyetje për DKRS-në, kur do të fillojë projekti i renovimit të stadiumit të qytetit? Pyetje për DKRS-në, 1 Qershori dita e fëmijëve, në Qendrën e Kulturës është bërë një shfaqje që nuk ka qenë fare e mirë, a keni ndonjë mendim për me na e dhënë për këtë film?

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Përgjigje pjesa për të cilën ju po flisni nuk është shfaqur sepse ajo pjesë është horror.

z.Rrahman Jakupi; Po lidhem me Albanën se ka pas një film por përmbajtja nuk ka qenë adekuate. Pyetje për Kryetarin, lidhur me Shtabin e Rancës Kryetari ka thënë se do të sjelli dokumentacionin, unë

e kamë bërë kërkesën për qasje në dokumente zyrtare, pse nuk po e sjell dokumentacionin, prej kujt po tutesh Kryetar?

z.Lumni Amrushi; Pyetje për DKA-në, për shkollën në Pjetërshticë rreth shkollës dhe ambulantes është një hyrje për parking dhe kërkojë që të rrafshohet ajo pjesë dhe duhet të bëhet një intervenim? Pyetje për DSHP-në, rruga "Idriz Ajeti" e shumë rrugë tjera janë dëmtuar kërkojë që këtë herë ti rregulloni rrugët që janë dëmtuar?

z.Muhamet Ademaj; Për te muri që u përmend nga kolegu , unë e kamë ndërtuar murin 2 metra brenda dhe i kam lënë hapësirë rrugës. D.m.th. unë kam hyrë brenda 2 metra në pronën time. Kjo mundë të verifikohet edhe nëse nuk është kështu unë e prishi murin menjëherë.

z.Hamëz Tërshani; Pyetja ishte se a ke marrë leje kaq?

z.Rexhep Gashi; Sqarim lidhur me vendimin për Komisionin e Aksionarëve, dorëheqja e juaj Besnik është aprovuar në Kuvend. Dhe ekzekutivi nuk ma ka sjellë vendimin për anëtarë të Komisionit?

z.Grejtalb Emini, DPUKGj; Përshëndetje, i kam shënuar 10 pyetje. Te rruga "Komandant Kumanova" e kamë thënë se është problem ajo pjesë ne jemi duke e bërë projektin. Nevojiten mbi 1000 metra gyp në rrugën "Komandant Kumanova". Sa i përket legalizimeve dhe pyetjeve mjedisore të gjitha kërkesat që kanë ardhë me postë ne jemi duke i shqyrtuar. Sa i përket trotuarit rrugës "Tahir Sinani" ato që janë shtruar nuk janë kubëza por gur natyralë dhe nuk ka rrëshqitje, nëse ka atëherë ka edhe hapësirë shtesë për të lëvizur ku është e shtruar me kubëza. Te rruga "Hyre Emini" deri te Halla e Sportit....? Sa i përket pyetjes së Besnikut për rregullimin e urës ne po planifikojmë që të paktën të bëhen muret mbrojtëse të urës sepse atë do ta rregullojmë. Sa i përket pengesave të rrugës "William Wollker" ato duhet të rregullohen mirëpo e kemi problemin edhe te kanalizimi e tek pastaj të bëhet renovimi i saj.

z.Adem Ramdani; Unë nuk thashë janë të rrjanë të rrëshqitshme për kur bie shi por kur bie borë, sepse kubëzat janë të mira por të rrëshqitshme te rruga "Tahir Sinani".

Kryetari z.Qemajl Aliu; Përshëndetje, faleminderit për pyetjet i kam shënuar pyetjet dhe po vazhdojë të përgjigjem rreth bursave do të angazhohem dhe do të flas me drejtoreshën, fat i mirë është që janë 80 bursa këtë vitë dhe me sa e di vitin e kaluar vetëm 84 studentë kanë aplikuar duke pasur parasysh që numri çdo ditë është në rënje dhe po mendojë që këta që do të aplikojnë do ta kenë fatin ti marrin, megjithatë ato para janë të destinuara për studentë do të mundohemi që procedurën mos ta pengojë asnjë njeri. Ndërsa te kontrata me KRM "Pastërtia" po jap sqarime K.R.M "Pastërtia" është Kompania Rajonale e Mbeturinave. Ne e kemi gjetë një kontratë me 43 mijë euro ku ka pas shumë specifika të cilat janë larje rrugësh, pastrim trotuarësh, kopshteve dhe pastrim të rrugëve kryesore për të cilat as 20% të specifikave nuk janë plotësuar. Ata këtë shumë e kanë konsideruar si një ndihmë për kompanin në bazë të kontratës. Unë e kamë gjetur këtë kontratë e kemi thirr menaxherin për vazhdimin e kontratës, por jo blanko dhe jo me konsideru si shpërlamje parash dhe taksa të qytetarëve të Shtimes pa kry shërbime. Ata janë deklaruar që ne nuk kemi kapacitete për me i përmbush qind për qind kushtet e kontratës. 6 muaj ka ndejt kontrata mbi tavolinë i kemi prit me ardh me nënshkru, por jo me nënshkru sipas tyre thjesht kështu me ju dhanë lekë si ndihmë por për ti kryer shërbimet ndaj qytetit dhe qytetarëve. Ne jemi detyru me e hap një kontratë përmes prokurimit dhe nuk e di kush mund të vijë. Në shkollën e Zborcit nuk jam i njoftuar tërsisht por do ta adresoj çështjen tek drejtoresha e DKA-së. Për Gurtheysit është brengë edhe e jona por nuk kemi rrugë tjera. Do të bëjmë përpjekje që nga buxheti ta bëjmë një rrugë vetëm për Kamiona. Për filmin e fëmijëve është bërë bujë. Mendoj se filmi ka qenë i papërshtatshëm për moshën e fëmijëve. Për qasje në dokumente zyrtare përgjigjet zyrtari kompetent. Për Shtabin paratë kanë qenë të pa mjaftueshme. Dhe në bashkëpunim me Agjensionin për Mbrojtjen e Monumenteve kemi ndarë një vlerë prej 125 mijë euro, dje e kemi prurur gurthemelin, përkundër përpjekjes tuaj që keni bërë për me pengua dhe sabotuar gurthemelin e UÇK-së. Pra buxhetin e kemi 125 mijë euro dhe do ta rifillojmë vitin e ardhshëm ju ftoj që ta prej shiritin bashkë. 33.500 ka qenë buxheti për rinin e tash i kemi bërë 66 mijë euro. Sa i përket klubeve sportive ato duhet të angazhohen edhe për forma tjera të financimit. Kriter ka qenë suksesi më i madh në sport. Komisioni ka bërë punë të mirë, dhe ndarja është bërë racionale.

z.Përparim Ramusa; Unë kërkoja me ditë se ku i keni hedhë mbeturinat gjatë kësaj kohe dmth. ku i keni hedh mbeturinat leglisht. Si është e mundur se Kryetari nuk është i njoftuar me mungesën e

arsimtarëve. Shtabin e kanë formuar veteranët e invalidë. Procedurat kanë fillur para se me ardhë ju këtu ajo është vlerë dhe ju duhet me bërë diqka.

Kryetari z.Qemajl Aliu; Unë i falenderojë punëtorët e KRM “Pastërtia”, të cilët edhe pse janë vonuar por prapë kanë ardhur dhe kamioni i KRM “Pastërtia” i ka marrë mbeturinat në mënyrë legale, nuk ka grumbullim ilegal të mbeturinave. Për arsimin procedurat janë 3 muaj. Në fillim kur e ka marrë detyrën ka pasë me 3 ose 4 arsimtarë me mungesa. Për Zborc më vjen keq që ka pasë mungesë të arsimtarit.

znj.Adelina Beqaj; Për pjesë problematike të rruga “Komandant Kumanova” të shkolla, mirë është me kry punën kur nxënësit janë në pushim. Te filmi mirë që kërkojë Kryetari falje për filmin. Mos meno që është meritë e jotja gurëthemeli të Shtabi në Rancë.

z.Rrahman Jakupi; Për mbeturinat e kemi deklaratën e menagjerit të KRM “Pastërtia” që ka thënë se nënshkrimi i kontratës është kushtëzuar me ndërrimin e menagjerit K.R.M “Pastërtia”.

z.Adem Ramadani; Për pjesmarrje në vërjen e gurthemelit të Shtabit të Rancës i ke disa akuza pa vend, unë nuk kam nevojë me vetë askënd për me marrë pjesë në vendosjen e gurëthemelit në Rancë. Mua më ka mbetë merak për mospjesmerrje dhe nuk kish mujt me më ndalë askush me asnjë shantazh. Vjet ka qenë i njejt Kryetar dhe une kam qenë aty.

z.Reshat Mujota; Te shtabi në Rancë unë jam në rrjedha edhe kur e keni nda buxhetin edhe shpronësimin e rrugës, e dyta edhe mua më ka mbet merak por kam qenë në mbledhje të Komitetit. VV-ja është në pushtet dhe e ka obligim me i kry punët dhe mos bëni dallime. Erdhi koha në drekë me shku e ne jemi te pika 2.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Pajtohem që UÇK-ja është e popullit dhe të gjithë duhet të jemi bashkë në gurthemele. VV-ja gjithmonë ka marrë pjesë në të gjitha takimet.

z.Lumni Amrush; Te pjesa e Shtabit shuma 5 mijë euro ka qenë shumë qesharake për zotriun këtu, problemi ka qenë te shpronësimi, mirë është që u pajtuan familjet aty dhe po bëhet. Le ta dëshmon që ky (Kryetari) ka qenë në Rancë në ditën e Shtabit para se me qenë Kryetar i Komunës.

Kryetari z.Qemajl Aliu; Më vjen keq por po del që ju vetëm kur jeni në pushtet jeni me plot gojën UÇK-ë e plot gojën për Shtabin.

znj.Zejnije Velu; Kërkoj që në seancën e radhës drejtoresha të na tregojë se çfarë masa disiplinore ka marrë ndaj atyre që e kanë përzgjedhë atë film për fëmijë. Sa i përket degradimit, ju jeni ata që e keni degraduar arsimin.

z.Albana Podvorica; Sa i përket filmit unë nuk thashë që ka qenë film horror por thashë se ka qenë film jo adekuat për fëmijë. Ne nuk vijmë të pa përgaditur në mbledhje.

z.Hamëz Tërshani; Zejnija po fol për degradimin e arsimit, a je aty ku punon në arsim në mënyrë adekuate me kualifikimin. Te Shtabi ju të VV-së dirigjoheni nga niveli qendror e lokal. Shoqatat janë në mesin tonë. Nuk e marrë guximin me thanë të dirigjuar. Unë nuk kam kurrfar ndikimi prej askujt për të marrë pjesë në tubime. Ne jemi shumë të rregullt në këto çështje, por është shumë e ulët nga ana e Kryetarit me thanë ashtu.

znj.Zejnije Velu; Faleminderit Hamëz, kjo nuk është çështja, sepse të gjithë i kanë ndryshuar partitë politike. Unë do ta mbrojë të drejtën e qytetarëve. Në Konkurs zotëri ceket saktësisht në mungesë të Kuadrit. Në kohën e qeverisjes së zotriut që tani janë në opozitë, unë me master kam mbetur jashtë e ju keni marrë në punë studentë ende pa diplomuar, kjo është e vërteta.

Pika 3

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026, (Pas diskutimit Publik)

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; KAB-i ka shkuar në diskutim publik, materialin e keni marrë edhe pse pak me vonesë kërkojë falje. Diskutimi publik ka filluar nga data 13.06.2023. Shumica apo me thënë të gjithë janë përfshirë në KAB. Nuk do të ju marrë kohë, pjesëmarrja ka qenë e mirë por jo e kënaqshme mjaftueshëm. Unë nuk kam pas mundësi të jem rregullisht në diskutimet publike por kolegët e mi e kanë bërë prezantimin final, dhe i kanë marrë propozimet. Nëse ka ndonjë pyetje unë jam i gatshëm të përgjigjem.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Unë kamë qenë pjesëmarrës dhe pjesëmarrja ka qenë shumë më e madhe se vitin e kaluar, na ka penalizu pak mbajtja e takimeve në orën 16:00. Disa nga Asambleistët kanë marrë pjesë aty ku kanë pasë kohë, faleminderit shumë. Ky është materiali e keni marrë pak me vonesë por është dashur me u punuar drafti final. Ka pas kërkesa por ju e dini nuk ka mundësi që të përfshihen të gjitha sepse shuma financiare është e kufizuar.

znj.Adelina Beqa; Faleminderit z.Ferati, vërejtjen e kam te totali vlera ka qenë 8 milion e 400 mijë euro kurse dje te materiali që na ke dërguar vlera totale është 8 milion e 733 mijë euro ka një diferencë. Këtë nuk muj me votu për shkak të projekteve të vogla që i keni e ju keni bërë premtime për projekte shumë më të mëdha. Ju mundeni me kalu por me mua jo. Unë e kam votuar Çerdhen në Petrovë.

z.Muhamet Ademaj; E falenderojë zyrtarin kryesor financiar z.Bujar Feratin për KAB-in. Kjo nuk është kornizë përfundimtare por vetëm kornizë orientuese dhe i paraqet politikat e Kryeatrit. Ne si grup parlamentarë do ta mbështesim dhe votojmë.

z.Përparim Ramusa; Çerdhja është votuar me kohë dhe keni genjyer. Te KAB-i ka vërejtje mes premtimeve, zotimeve dhe draftit të KAB-it. E para te shkarkimet me Karitas-in ne i konsiderojmë të ligjshme e ju i keni dezinformuar qytetarët se janë të pa ligjshme. A ka premtu Kryetari shkollë të re në Petrovë edhe Çerdhe. Ka premtu nënkallime në Davidovc, Belincë, Pjetershticë. Për vitin 2024 Kryetari për fshatin thuaj se më të madh në Komunën e Shtimes i ka ndarë 45,000 euro. Ke premtu Autostradën nëpër Shtime. Si përfundim nuk mundet me u votu ky KAB.

z.Reshat Mujota; Te ky KAB mua më bënë me u quditë, te kolona 8 kodi 3-8 te rruga “Sopa”, trotuarë nga salla e sportit deri te qeshmja në Mollopolc. Tash bartet edhe në 2024 me totalin 70.000 euro. Planifikim për 2024 në rrugë kanë qenë edhe 15.000 euro, në vitin e kaluar unë kam kërkuar edhe 10.000 euro dhe këtu ka dalë edhe ai 10.000 euro që e kam kërkuar. Zona e Neredimës “Trotuarë” le të mbetet në 2023 e jo të bartet në 2024. Unë dua me i nda projektet. Nga qeshmja deri te salla e sportit në Mollopolc është projekt në veti edhe trotuari te rruga “Sadik Mujota” është projekt i veçant. Kërkesat e dëgjimit publik i kam shikuar veq e veq, normal ato që janë më primare. Kërkoj nga drejtori që të rrafshohet deri te rruga “Drita Mujota” me qëllim për rregullimin e vend-ndaljeve për autobus. Nuk është futur pjesa e rrugës “Islam Neziraj”. Për sa i përket lumit kërkesa ka qenë për rregullimin e shtratit të lumit e jo pastrimi i lumit. Këto janë kërkesat e miya dhe pa u përfshi në KAB unë jam në “Abstenim”. Kërkoj sqarim nga drejtori.

z.Bujar Ferati, ZKF; Po e ndjej si obligim me sqaru ky është një proces që vazhdon, në këtë fazë punohet ashtu që ti mbrojmë këta kufi të cilë kemi mendua që mundë të ia dalim si në kategorinë e pagave po ashtu edhe në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, kategorinë e subvencioneve dhe shpenzimeve komunale. KAB-in e dytë në muajin Gusht duhet të finalizohet. Ka edhe gabime teknike por para se të shkojë në departament të buxhetit do të rregullohet. Kemi projekte të cilat ose kanë kontrata ose janë në proces të tenderimit. Ka kohë edhe mundësi për me u plotësuar prapë. Bartja e nxënësve është nga DKA-ja që mundë ta merrni si po. Me rëndësi është se a janë funksionu të gjitha dhe a është marrë si duhet zëri i qytetarëve.

z.Asllan Beqa; Përrshëndetje, te KAB-i, pas dëgjimit publik kemi hartuar një draft gjithpërfshirës. Dëgjimet i kemi mbajtur, sa i përket Çerdhes në fshatin Petrovë kemi pas dakordim të plotë, mirëpo i njeiti person që nuk ka varreza fare në atë pjesë ku do të ndërtohet Çerdhja, më pas publikisht ka thënë se aty ka varreza. Ka me u bë rruga, ka me u bë ura. Është tmerr se si anëtarët e Komisionit me ty Adelina, hapur me e shkelë rregulloren. Janë duke u bërë investime të mira.

z.Lumni Amrushi; Përrshëndetje, e di që krejt ato punë kanë me u kry por janë bërë edhe më herët ato punë. Po lidhem me KAB-in debatet janë mbajtë, pak më shumë ka pasë pjesëmarrje. Në Pjetërshticë u propozu një rrugë si një rrugë që nuk egziston fare, e pashë që ka hi në KAB, u kujdesa me drejtorin që me largu sepse nuk egziston ajo rrugë. Kisha kërku që disa rrugë që kanë mbetë pa u shtru si rruga “Peja” a pritet me u rregullua? Pastaj rruga te Gjamija është pa emër a pritet me u asfaltuar? Si dhe pastrimi i lumit të fshatit? Dhe është një kërkesë tjetër, rruga që i lidhë dy fshatrat Pjetërshticën dhe Zborcin dhe e lidhë edhe Dugën.

z.Grejtalb Emini, drejtori i DPUKGJ; Po lidhna te pjesa e Lumni Amrushit është gabim teknik te rruga “Mulla Maliqit”. Rruga që e lidhë Pjetërshticën me fshatin.... kemi me bisedu Ministrin, por nuk e di gjatësinë e rrugës, por kemi me hapë edhe me asfaltu. Shumica e fshatrave i kanë rreth 75.000 euro në projekte kapitale. Te rruga “Islam Neziraj” është si aneks, ku përfshihet trotuari dhe ndriqimi. Disa kërkesa që i pashë janë të arsyeshme. Projekti nga Halla e sportit deri në hyrje e Mollopolcit është projekt 2 vjeçar dhe fillon këtë vit.

znj.Albana Podvorica; Deshta me pyet zyrtarin financiar se a është i përfshirë edhe renovimi i stadiuimit në dokumentin e KAB-it?

znj.Zejnije Veliu; Pajtohem me zotri Mujota për punën e transportit që lidhja të zgjatet. Te shkolla “Emin Duraku” në objektin lartë kërkojë të bëhen shkallët emergjente. Janë ndërtuar shkollat por këtyre nuk ju ka interesuar cilësia por sasia.

z.Rahman Jakupi; Sa i përket dëgjimeve publik ka pas, por ka pas mungesë të gjinisë femërore, kërkojë që të ketë prezencë të gjinisë së kundërt.

z.Adem Ramadani; Ka pasë kërkesë për rregullimin e dy urave në fshatin Reçak e nuk janë përfshirë në procesverbalin që është mbajtur në dëgjimin publik? Me 50.000 euro janë përfshirë kogjo do sene e nuk mundë të realizohen. Janë përmendur segmente e unë nuk e di për cilat segmente po bëhet fjalë. Unë i kam përmendur rrugët e jo segmentet, rrugët si “Qorr Ilazi” dhe “William Woker” janë rrugë këto e jo segmente.

z.Rexhep Gashi; Faleminderit për elaborimin. Te procesverbalet që janë bërë nuk janë përfshirë diskutimet publike. Unë kam qenë pjesëmarrës në Pjetërshticë, ata kanë problem me kanalizimin dhe me ujësjellsin, nuk është përfshi këtu. Rruga deri te shkolla unë e kamë përkrahë “Hafir Dugollin”. E shohë si jo serioz ekzekutivin dhe drejtorët që diskutimet e qytetarëve kanë qenë kërkesa e nuk janë përfshi në projekt e as në procesverbal dhe kërkojë që këto kërkesa të qytetarëve të përfshihen në këtë dokument.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Nuk mund të futen të gjitha kërkesat në një buxhet. Por është mirë me fol për prioritetet që kanë nevojë qytetarët në secilin fshatë. Pajtohem me Ademin që rrugët “Qorr Ilazi” dhe “William Woker” nuk janë segmente por janë rrugë.

z.Besnik Seferi; KAB-i është shumë i rëndësishëm, është bërë një punë shumë e mirë nga ekzekutivi, unë kamë marrë pjesë. Nuk është e mundur që të gjithat kërkesat me u përfshi. Është mirë që nga drejtori të na bëhe e qartë se sa janë të parapara shumat, me sa e di unë e kam informatën Buxheti duhet të ndahet për kokë banori. Në KPK-ë i kemi bërë 4 rekomandime e nuk e di a kanë ardhur, kemi pas kërkesë që të plotësohet një zyrtarë në ZKKK-ë dhe funksionalizimi i qendrave mesimore për komunitetin pakicë. Dhe kemi kërkuar po ashtu një kod buxhetor për me i nda 1500 euro për manifestimin e festave të komunitetit pakicë. Po ashtu kemi kërkuar edhe asfaltimin e rrugës “Hysiqi” deri te pusetat e ujësjellësit. Me një gjë të cilën nuk pajtohem është kur zyrtari financiar tha se për shkaqe personale nuk ka mujt me marrë pjesë në debate publike gjë e cila ligji e obligon që të marrë pjesë në këto dëgjime publike. Përndryshe i përgëzojë dy drejtorët për diskutimin.

Kryetari z.Qemajl Aliu; Po flasim për KAB-in që kemi mundësi me i detajizuar rrugët deri sa të miratohet përfundimisht. Sivjet e kemi buxhetin për 1.1 milion më shumë. Kemi edhe 2.5 vite qeverisje ku do të realizohen të gjitha projektet e premtuara. Qytetarët kanë filluar që të besojnë në qeverisjen tonë të mirë, prandaj edhe kanë filluar që të adresojnë kërkesat e tyre nëpër dëgjimet publike, dhe kjo neve na gëzon mjaftë shumë. Unë vetë do të kujdesem që ky buxhet 2.6 milionshi me u shpërnda në mënyrë të barabartë në 18 fshatrat e banuar plus edhe në dy fshatra që janë pjesërisht të banuar, që i bie secili fshat varësisht prej madhësis të përfitojë 70-80 përkatësisht 100.000 euro. Prioritetet kanë me i përcaktu vetë banorët e lagjes ku jetojnë. Prioritet ka me qenë rruga që ka më shumë familje. Projektet që kapin shifrën mbi 100.000 mijë euro do të bëjmë përpjekje që ti realizojmë me qeverinë dhe me donatorë. Projektet për fatin e mirë tonin po i tejkalojnë edhe pritjet tona. Pritet të fillojnë projektet siq janë ai i Entit Special, “Tranziti”, “Unaza e Madhe”, rruga “Shtime-Lipjan”, tani më 4 Çerdhe të reja u bënë realitet. Dua ta përmend çerdhën e Petrovës që është në këtë KAB, ku janë 40.000 mijë euro, dhe ne do të shofim deri në fazën e fundit të miratimit të këtijë buxheti, nëse ne arrijmë të përfitojmë nga buxheti i shtetit ne mundë ta ndryshojmë këtë shifër, në të kundërtën nëse nuk arrijmë të marrim miratimin e buxhetit qendror atëherë

ne do ta bëjmë me forca tona vetanake. Unë ju sigurojë që brenda këtij mandati banorët e Petrovës ta gëzojnë çerdhën. Projekt tjetër madhor është stadiumi i qytetit që kap shifren mbi 2.3 milion euro që është miratu në Ministrinë e Kulturë Rini dhe Sport dhe që do të realizohet. Edhe për autostradën kam informacione të sigurta që në buxhetin e vitit 2024 do të jetë determinues që edhe ky aks që është i rëndësishë kombëtare jo vetëm i Shtimes por edhe rrethinë e më gjerë do të realizohet. Ju ftoj që unanimisht ta miratoni KAB-in, për periudhën 2024-2026.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Faleminderit për secilin që i dha vërejtjet dhe komentet e tijë. Pajtohem me shumicën e propozimeve. U pajtova edhe me zotri Rrahmanin kur foli për barazinë gjinore, e përkrahu maksimisht këtë nismë. Ju faleminderit të gjithëve dhe do ta kemi parasysh rritjen e buxhetit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për” me 9 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstënim” miratoi, Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2024-2026.**

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Po shkojmë në pauzë në ora 12:52h deri në ora 14:00h.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Vazhdojmë me mbledhjen e Kuvendit në ora 14.10h.

Pika 4

Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për verifikimin e ndarjes së Subvencioneve për OJQ-të (Pikë shtesë)

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Propozojmë që komisioni të jetë gjithëpërfshirës prej 5 anëtarëve PDK-1, VV-1, LB-1, LDK-AKR-1 dhe i pavarur-1. Nga PDK-ja propozojmë z.Rrahman Jakupin.

z.Rexhep Gashi; Ne pajtohemi me formulën që u propozua, dhe pranojmë.

z.Përparim Ramusa; Po e propozoj Rexhep Gashin dhe Reshat Mujotën.

z.Kadri Emini; Po e elaboroj pak këtë pikë, ne jemi “kundër” sepse unë nuk kam absolutisht asnjë dyshim se aty diqka ka shku keq, megjithatë kjo pikë e rendit ka kalu dhe le të zgjidhet e le ti shikojnë. Ne nuk kemi propozim për formimin e këtij komisioni.

z.Asllan Beqa; Unë e kisha adresuar këtë çështje te zyrtari ligjor edhe ne nuk kemi emra për komision deri sa nuk e dim a është e ligjshme.

z.Rrahman Jakupi; Faleminderit Kryesues, neni 11, dhe neni 40 pika e 8 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale e lejon këtë, dhe ne nuk jemi duke bërë komision hetues, nuk është kjo e keqe kjo veq qka e rrit transparencën.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Unë jam “pro” që ta shtyejmë këtë pikë për seancën e ardhëshme dhe ta kemi një opinion ligjor.

z.Kadri Emini; Unë e di që Kuvendi ka të drejtë me formu komisione, por ska të drejtë me formu një komision që për mendimin tim don me hetu një rast të caktuar.

z.Përparim Ramusa; Janë ankuar 9 klube sportive dhe ju thonë nuk kemi të drejtë me themelue një komision. Çka ju pengon juve, po më befason kjo nga ana juaj, të lutem qite në votim.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Rregullorja ishte me mangësi dhe kemi diskutur që ta ndryshojmë këtë rregullore. Unë po propozoj me shty për seancën tjetër e mos të na e kthen MAPL-ja si të kundërligjshme sepse po e keqëson performancën.

z.Asllan Beqa; Nuk jemi kundër por duam të sigurohemi, a është në pajtim me ligjin edhe mbledhja e Kuvendit nuk është larg.

z.Hamëz Tërshani; Zotria e përmendi nenin dhe tha është e ligjshme. Komisioni është me numër tek prej 3 anëtarëve dhe vazhdojmë tutje.

z.Reshat Mujota; Kërkojë falje që nuk kesh prezent në kohë të propozimeve, sa i përket komisionit unë nuk jam jurist dhe nuk e di a janë të ligjshme apo të paligjshme, ne jemi Kuvend dhe vendimet i zbaton ekzekutivi. Unë këtë komision e shoh sikur me kërkuar qasje në dokumenta zyrtare.

z.Besnik Seferi; Parimisht unë isha “pro” që të formohet si Komision, mirëpo ne nuk kemi kurrfar raporti nga Komisioni dhe do të ishte mirë nëse anëtarët e Komisionit kishin qenë këtu. Vërejtje për zyrtarin ligjor

është turp që nuk është në mbledhjen e Kuvendit. Mirë është me shty që ta diskutojmë dhe ta kërkojmë një raport nga Komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Pajtohem plotësisht me z.Seferin që duhet ta kemi një raport nga Komisioni për ndarjen e subvencioneve, sepse nuk e dimë ne fare se si ka rrjedhë puna e tyre për ndarjen e subvencioneve, e tek pastaj mund ta bëjmë komisionin e tillë.

Kryetari z.Qemajl Aliu; Ju lutem për diqka që nuk jeni të sigurt dhe nuk e keni të qartë mos merrni vendime sepse e dëmton imazhin e Kuvendit. Nxitimi të dërgon në një konkluzion të gabuar e që është një kthim mbrapa nga MAPL-ja. Nuk jemi kundë komisionit le të formohet në përputhje me ligjin, secilit anëtarë pra i them mos u nxitoni sepse kjo ka kosto.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Mund të marrim 5 minuta pauzë për konsultime dhe pastaj vazhdojmë mbledhjen në ora 15:15h. Në vazhdim Kryesuesi fjalën ja dha z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor.

Zyrtari ligjor, z.Lulzim Muharremi; Nuk jamë në ngjarje vetëm sa erdha, ju lutem më tregoni se për qfarë komisioni është fjala.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Sqaroj për pikën shtesë të propozuar nga opozita dhe të futur në rendin e ditës për formimin e komisionit për verifikimin e ndarjes së subvencioneve të OJQ-ve.

Zyrtari ligjor, z.Lulzim Muharremi; Unë po kërkoj me u shty kjo pikë për me marrë më shumë informata për ligjet dhe praktikën e tjera, për mos me qenë i njëanëshëm. Kjo është një formë e ndërhyrjes në punën e komisionit për ndarjen e subvencioneve. Zyra ligjore e MAPL-së është fatë i madh që e kontrollon ligjshmërinë e vendimeve të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Sa po e shohë në bazë reagimit të juaj edhe ju jeni për me shty këtë pikë.

Zyrtari ligjor, z.Lulzim Muharremi; Më e mira është me shty për mbledhjen e radhës për me mujt me e gjetë më të mirën.

z.Përpaim Ramusa; Ne nuk jemi për me shty këtë pikë deri në mbledhjen e radhës.

z.Kadri Emini; Kuvendi ka të drejtë formimin e komisionit, por për detyrat e komisionit unë nuk jam dakord.

z.Asllan Beqa; Neni 40 i LVL-së e lejon formimin e komisionit por nuk e sqaron për qfarë e lejon.

z.Rexhep Gashi; Ti qysh në fillim ke bërë shkelje ligjore sepse u dasht me lypë interpretim ligjor nga zyrtari. Unë nuk jam për me shty, qite në votim.

z.Reshat Mujota; U krijua një kaos këtu, detyra jote Kryesues është me luajtur një rol të pa anshëm. Përfaqësuesi ligjor është këtu për me na sqaru dhe jo për me kërku kohë. Emri im u propozu këtu, MAPL-ja e kthen njoftëse është kundër ligjore. Unë kërkoj prej PDK-së edhe njëherë të sqarohemi se a po e shtyjme këtë pikë a po e qesim në votim. Unë jamë anëtarë i pavarur.

Zyrtari ligjor, z.Lulzim Muharremi; Është lehtë me thënë, por interpretimi është gjëja më e vështirë. Nuk lejohet me ndërhy në punën e ekzekutivit e as ekzekutivi në punën e Kuvendit.

z.Përpaim Ramusa; Në fillim ne e futëm si pikë shtesë, për mua ky komision është i arsyeshëm.

z.Kadri Emini; Rrethanat janë krijuar në momentin e debatit për me shty këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 11 vota "Për", me 9 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim", miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për verifikimin e ndarjes së Subvencioneve për OJQ-të, në këtë përbërje:**

1. Reshat Mujota - (I pa varur)
2. Rrahman Jakupi - (PDK)
3. Rexhep Gashi - (LB)

Pika 5

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF-së me anëtarë të ri

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Unë para se të hapi diskutimin për këtë pikë propozojë që ta shtyjme këtë pikë për mbledhjen e radhës, me arsyetimin që të ulemi përfaqësuesit e grupeve pralamentare dhe të gjejmë zgjidhjen e duhur.

z.Përpaïm Ramusa; Unë e përkrahu propozimin e juaj Kryesues.

z.Reshat Mujota; Edhe unë jamë për me shty. Vendimi tu ka kthi nga Ministria për shkakë të kuotës dhe jo për shkakë të Reshat Mujotës.

***Kuvendi i Komunës, Unanimisht vendosi që pika e rendit të ditës me numër 4 “Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri”, të shtyhet për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës të Kuvendit.**

Pika 6

Propozim-Vendim për plotësimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/32 për ndarjen nga 100€ për Nënata-Lehona për vitin 2023

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Sqaroi shkurtimisht se gjatë ndarjes shtatë ndarjes së këtyre mjeteve ekzekutivi ka hasur në raste kur nënat lehona nuk e kanë shtetësinë e Kosovës, por që janë të martuara në Kosovë, dhe kanë fëmijë. Kërkesa është nga drejtorija që me vendim të ju mundësohet që edhe kësaj kategorije të nënave ta gëzojnë të drejtën e këtyre 100 eurove sikurse edhe të tjerat.

z.Reshat Mujota; Në KPF i kamë parë rekomandimet dhe më kanë pëlqyer, por ne sidomos me komitetin e shëndetësisë e kemi vërejt këtë çështje dhe e kemi mbështet drejtorin që do të ju jepet mundësia edhe atyre nënave lehona që janë me leje qëndrim pa nënshtetësi. Nuk flitet vetëm për një rast ka edhe plot raste të tjera, dmth jamë “për” që të bëhet edhe për nënat lehona që janë vetëm me leje qëndrim në Kosovë. **Zyrtari ligjor, z.Lulzim Muharremi;** Edhe unë ja kam dhënë një rekomandim të tillë drejtorit, por ajo që po kërkojë unë është që edhe ato nëna që kanë lindur fëmijë të vdekur të futen në këtë vendim.

z.Përpaïm Ramusa; Pajtohem me propozimin e zyrtarit ligjor që edhe këto nëna të futen në këtë shumë prej 100 euro.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi Komunës, unanimisht miratoi Vendimin për plotësimin e vendimit të Kuvendit Npi – 01/32 të datës 27.01.2023, për ndarjen nga 100€ (njëqind euro) për secilën Nënë-Lehonë, për ç’do fëmijë të lindur në vitin 2023, si vijon:**

Në dispozitiv të vendimit Npi – 01/32 shtohen edhe fjalët:

1. (“Të drejtën mbi bazën e vendimit Npi-01/32 për përfitimin e 100€ për çdo fëmijë të lindur e gëzojnë edhe të gjitha Nënata lehona që nuk e posedojnë shtetësinë e Kosovës por që janë të martuara me burrat që kanë shtetësinë e Kosovës”).

2. Të drejtën mbi bazën e vendimit Npi-01/32 për përfitimin e 100€ e gëzojnë edhe të gjitha Nënata lehona që kanë lindur fëmijën pa shenja jete ose që pas lindjes ka ndërruar jetë.

Pika 7

Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. Me numër P-03020-2 ZK-Shtime

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Para se të hap diskutimin për këtë pikë lexoi rekomandimin e KPF-së.

z.Rexhep Gashi; Pikërisht nga drejtori neve na vjen një rekomandim e ne kemi kërkuar një ligjshmëri, e pastaj po thuani naj kthen MAPL-ja. Drejtori nuk ka thënë diçka tjetër por vetëm e ka bërë një copy - paste.

z.Grejtalb Emini, DPUKGj; Ju keni kërkuar nga unë një rekomandim dhe ky rekomandim është i bazuar në të gjitha bazat ligjore dhe planin zhvillimor komunal.

znj.Zejnie Velu; Zotria në fjalë që po diskuton ka qenë anëtar i Kuvendit edhe atëherë, pse nuk e kanë ndërruar destinimin e kësaj prone që atëherë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi Vendimin për ndrrimin e destinimit të Ngatrës Kadastrale Nr. P-03020-2, me sipërfaqe totale 1788m², Z.K-Shtime, Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes, që të destinohet nga prona bujqësore në pronë ndërtimore.**

Pika 8

Propozim-Vendim për hapje të rrugës publike në Z.K – Karaqicë

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë sçaroi Propozim-Vendim për hapjen e rrugës publike në Z.K – Karaqicë.

z.Muhamet Ademaj; Unë mendojë se kjo rrugë duhet të hapet. Ne do ta përkrahim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 16 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 15 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi Vendimin për Destinimin në Rrugë Publike, pjesën e Ngatrës Kadastrale Nr. P-00325-0 me sipërfaqe prej 153 m² (ku sipas gjendjes në teren rruga do të ketë gjerësin 6 m), në Zonën Kadastrale - Karaqicë, Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes.**

Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbedhjen e përfundoi në ora 15:58h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

